



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 10.5.2023

Nr: 483

Ora: 13:30

V E N D I M

MBI DENONCIMIN NR. 326 ID, TË KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA (KRIIK), NDAJ PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

Sot më datë 10 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim denoncimin që i përket:

KËRKUES: Organizata Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

OBJEKTI: Kërkohet heqja e materialeve propagandistike të vendosura në vendet e afishimit të reklamave, në Bashkinë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, e 2, neni 79, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhor”, si dhe vendimi nr. 424, datë 03.05.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për heqjen e materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...” (vijon emri i subjektit zgjedhor)”

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Organizata KRIIK ka depozituar denoncimin regjistruar me nr. 326 ID, mbi “Marrjen e masave urgjente për heqjen e materialeve propagandistike, statike të subjektit zgjedhor, “Partia

Data: 10.5.2023 Nr: 483
Ora: 13:30



“Mbi denoncimin nr. 326 ID, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ndaj Partisë Socialiste të Shqipërisë”

Socialiste e Shqipërisë”, në territorin e Bashkisë Tiranë. Sipas KRIIK, këto materiale propagandistike janë vendosur në shkelje të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor dhe udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Më konkretisht, organizata KRIIK denoncon se: “...Bashkia Tiranë ka afishuar në vendet e reklamave ndriçuese buzë rruge, ku zakonisht vendos reklamat me pagesë, materialet propagandistike të subjektit zgjedhor Partia Socialiste...”. “...Është publikuar posteri i përgatitur dhe shpërndarë me logo të Partisë Socialiste, i cili në vetvete, në analizë të përmbajtjes sipas opinionit të KRIIK, përmban elementë të fortë të diskriminimit dhe të gjuhës së urrejtjes, totalisht pa asnjë lidhje me një proces zgjedhor, llojin e zgjedhjeve për të cilën garohet dhe mesazheve që përcjell.

Këto postera janë vendosur në vendet e afishimit të reklamave në thuajse të gjitha rrugët kryesore të Tiranës, madje deri në rrugët anësore të autostradës Tiranë – Durrës deri pranë mbikalimit të Rinasit, duke i krijuar avantazhe domethënëse subjektit zgjedhor Partia Socialiste, prishur parimin e barazisë në garë, si dhe ngritur pikëpyetje mbi mbulimin e kostove të reklamimit të këtyre posterave në këto vende.”.

Në vijim të procedurave të hetimit administrativ, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 4043 Prot., datë 20.04.2023, ju drejtua subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, nëpërmjet të cilës kërkon informacion, në lidhje me:

- Procedurën e ndjekur nga ana e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, apo subjekteve të kontraktuara prej saj për afishimin e materialeve propagandistike;
- Arsyet e mos vendosjes së shënimit në materialin propagandistik sipas përcaktimeve të kërkesave të nenit 79, pika 3, të Kodit Zgjedhor “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të”.

Gjithashtu në vijim të procedurave të hetimit administrativ, struktura përgjegjëse pranë KQZ ka urdhëruar menjëherë monitoruesit e Qarkut Tiranë, për të verifikuar rastet objekt denoncimi. Monitoruesit vendosën në dispozicion të KQZ-së 6 raporte monitorimi, nëpërmjet të cilave konstatohen shkeljet e denoncuar. Çdo raport i monitoruesve është shoqëruar me foto të materialeve propagandistike të gjetura gjatë monitorimit.

Në seancën publike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, datë 25 prill 2023, Komisioneri kërkoi që subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, brenda 48 orëve të vendosë në dispozicion të KQZ-së të gjitha marrëveshjet kontraktuese, të bëra nga Partia Socialiste e Shqipërisë me subjekte tregtare për afishimin e materialeve propagandistike pa qenë e nevojshme të sjellin aspektin financiar.

Në datën 27 prill 2023, subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” ka sjellë në KQZ kopje të kontratave të lidhura me 2 kompani private, respektivisht kontratë e lidhur më datë 11.04.2023 me

kompaninë DIXHI PRINT-AL, objekt i kontratës është dhënia e hapësirave publicitare në rrugët nacionale për fushatë dhe zgjedhjet lokale 2023 dhe kontratë e lidhur më datë 14.04.2023 me kompaninë B.N.I sh.p.k., objekt i kontratës është bashkëpunimi në realizimin e programit publicitar në “outdoor advertising” në ekranet Led Display.

Referuar pikës 2, të nenit 79 të Kodit Zgjedhor, parashikohet se...“Gjatë fushatës zgjedhore përdorimi dhe afishimi i çdo materiali tjetër statik për propagandë zgjedhore, përfshirë flamujt dhe posterat, lejohet vetëm në një largësi prej deri 5 metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës”. Referuar denoncimit të mësipërm, vendosja e materialeve propagandistike është bërë në stenda afishimi (Billboard) LED të cilat janë vendosur në Bashkinë Tiranë. Ligji parashikon se subjektet private mund të pajisen me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike për qëllime të ndryshme, ndër të cilat është dhe reklamimi. Bashkitë miratojnë rregulloret përkatëse për shfrytëzimin e hapësirave publike, duke përcaktuar afatet e lejes, dokumentacionin e nevojshëm, afatin e shqyrtimit e specifikime të tjera. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, stendat e afishimi (billboard) konsiderohen prona private pasi për to është marrë lejë specifike për përdorimin e hapësirave publike nga subjektet që ushtrojnë aktivitete reklamuese për (City Lights) dhe (Tabelat Reklamuese Led).

Neni 79, pika 1, i Kodit Zgjedhor, specifikon se: “...kryetari i bashkisë përcakton vendet publike në territorin e bashkisë, përkatëse për afishimin e materialeve propagandistike prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore.”. Stendat e afishimit të cilat janë përdorur për transmetimin e materialeve propagandistike, nuk janë prona publike, por janë prona private me leje të posaçme për reklamim. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për kallëzimin e kryer nga organizata KRIIK, pasi në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se, denoncimi nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 79, të Kodit Zgjedhor dhe udhëzimin nr. 6/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Për sa i përket afishimit të materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...” (vijon emri i subjektit zgjedhor), Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 424, datë 03.05.2023, vendosi heqjen e të gjitha materialeve propagandistike që nuk e përmbajnë këtë shënimin duke ngarkuar për zbatim të vendimit policitë bashkiake dhe Policinë e Shtetit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, e 2, nenin 79, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, si dhe vendimin nr. 424, datë 03.05.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për heqjen e

materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...” (vijon emri i subjektit zgjedhor)”,

V E N D O S:

1. Moskonstatimin e shkeljes administrative dhe pushimin e procedimit administrativ ndaj subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Ky vendim do t’u njoftohet policive bashkiake, nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI